



INSTITUCIONET E PËRKOHËSHME VETËQEVERISËSE
QEVERIA E KOSOVËS / MINISTRIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS I KOSOVËS



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës
Nezavisni Nadzorni Odbor Kosova
The Independent Oversight Board Of Kosovo

A map of Kosovo is shown in the background, with a semi-transparent image of a large, modern building (likely the Parliament of Kosovo) overlaid on it. The text is centered over the map.

Raport Vjetor 2006
Godišnji izveštaj 2006
Annual Report 2006

Prishtinë 2007

H Y R J E

Këshilli i Pavarur Mbikqyrës i Kosovës(KPMK)duke rrespektuar dispozitën e nenit 14.1 të RReg 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës e me qëllim të informimit të plotë për aktivitetin e tij gjatë vitit 2006 ka këndësuar që organeve kompetente dhe publikut të gjërë t'i paraqesë raportin vjetor për vitin e kaluar.

Të bindur "*realizimi i objektivave nuk bëhet nga njerëzit por nëpërmjet njerëzve*" "KPMK realizimin e objektivit të tij primar të Mbikqyrjes së tërësishme të aplikimit të Ligjit Për Shërbimin Civil nuk e ka sforcuar vetem komponenten thjeshte **mbikqyrese** dhe **imponuese** por në masë të madhe i ka dhënë hapsirë konsultave,këshillimeve dhe bashkëbisedimeve me autoritetet punëdhënëse në Shërbimin Civil të Kosovës.

Kjo çasje ka rezultuar me një mirëkuptim të dyanshëm,me evitimin e të metave të konstatuara dhe me ngritjen e nivelit të profesionalizmit në SHCK.

Tërë aktiviteti i KPMK-së që pasqyrohet në këtë raport ka qëllimin e tij të vazhdueshëm që ky organ të jetë garant i një Shërbimi Civil etik,të bazuar në ligj,i shumëllojshëm , efikas dhe mbi të gjitha në shërbim të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe këtë duke pasur parasysh faktin se një shërbim civil i organizuar mirë me një administratë kompetente është parakusht i funksionimit të institucioneve demokratike dhe sinjal i sundimit të së drejtës

Natyrisht ky raport vjetor i dyti me radhë që harton Këshilli nuk ka pretendim të shpalosë të gjitha që janë bërë brenda vitit raportues ,por do vëjë në spikamë pikat kryesore - dominate të aktiviteteve të tij duke përfshire atë që cilësohet si *sukses* i këshillit,*vështiersi* gjat punës ,mangësi apo ngecje në ushtrimin e detyrave dhe Sfidat e të ardhmës e veçanërisht *transformimin* e tij në një organ që do të raportojë drejtpërsëdrejti Kuvendit të Kosovës.

Askush nuk mund të jetë plotësisht i kënaqur me atë që është bërë sepse gjithmonë ekziston më shumë e më mirë,por në pëgjithësi KPMK mendon se objektivat e tij të parapara për 2006 në masë të madhe janë realizuar dhe do të vazhdojë me të njejtin përkushtim edhe në vitin vijues.

Me këtë rast falenderojmë Qeverinë e Kosovës,UNMIKU-n,OSBE,DFID Dhe të gjitha Autoritetet Punëdhënëse në SHërbimin Civil të Kosovës për bashkëpunim korrekt.

Me rrespekt:

PËRMBAJTJA

Hyrje.....	faqe 2
Shkurtesat.....	faqe 4
Këshilli i Pavarur Mbikqyrës	faqe 5
Baza Ligjore e Veprimit	faqe 6
Funksioni i ankesave	f/7-18
Implementimi i vendimeve.....	f/ 19-22
Funksioni i Shqyrtimit të Emrimeve të Drejtorëve Të Departamenteve në SHCK.....	f/23-31
Funksioni i rrespektimit të Ligjit të SHCK.....	31-36
Aktivitete të tjera të Këshillit-bashkpunimi Me Organe tjera	f/36-43

SHKURTESAT

KPMK- Këshilli i Pavarur Mbikqyrës i Kosovës

IPVQ- Instucionet e Përkohëshme të Vetqeverisjës

UNMIK- Misioni i Kombeve të bashkuara në Kosovë

PSSP- Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm

MSHP- Ministria e Shërbimeve Publike

SHCK- Shërbimi Cilil i Kosovës

K.E - Kryeshef Ekzekutiv (i komunës apo Agjensionit ekzekutiv)

RREG.- rregullore për Shërbim Civil të Kosovës

UA- Urdhëresa Administrative (2003/2)

LPA - Ligji Për Procedurën Administrative

UA- Udhëzimet Administrative(2005/01 dhe 2005/02)

QKUK-Qendra Klinike Universitare e Kosovës

UP -- Universiteti i Prishtinës

AP-Autoritet Punëdhënës

OSBE- Organizat për Bashkpunim e Siguri ne Europë

DFID-

KËSHILLI I PAVARUR MBIKQYRËS I KOSOVËS

Këshilli i pavarur mbikëqyrës i Kosovës është organ i themeluar me rreg. e UNMIK-ut 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës me të cilën janë paraparë: funksionet, përbërja, kompetencat dhe fushveprimtaria e këshillit.

Këshilli zyrtarisht është formuar me 23 shtator 2004, me ç`rast anëtarët e KPMK kanë ë bërë betimin solemn dhe kanë filluar me aktivitetin e tyre në këshill.

KPMK ka shtat anëtar të cilët emërohen nga PSSP me pëlqimin e Kryeministrit të Kosovës ,duke u zgjedhur sipas konkursit publik, në proceduara të hapura konkurruese dhe duke rrespektuar parimin e meritës.

Këshilli ka kryetarin e këshillit të zgjedhur nga këshilli.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit Për Shërbimin Civil anëtarët e KPMK-së nuk janë shërbyes civil.

Këshilli ka sekretariatën e tij i cili përbëhet nga punëtorët që janë shërbyes civil në kuptimin e lligjit dhe që për nevojat e KPMK-së kryejnë punë administrativo-teknike e pregaditore dhe janë staf mbështetës i këshillit

Anëtarët e këshillit zgjidhen për një afat kohor të paraparë me ligj dhe mund të shkarkohen nga detyra vetëm në rastet e parapara me ligj .

Të gjithë anëtarët e tanishëm të Këshillit kanë një përvojë pune në Administratën publike, në menaxhimin e resurseve humane dhe përvojë në gjykatat e Kosovës që absolutisht i bënë ata të përshtatshëm dhe kredibil në ushtrimin e funksioneve të anëtarit të Këshillit.

këshilli sipas ligjit në fuqi ka tri funksione kyçe ;

- Funksionin e zgjedhjes së ankesave të shërbyesve civil dhe aplikueëve për punë në SHCK në shkallë të fundit në procedurën administrative

- funksionin e shqyrtimit të emërimeve të udhëheqësëve të departamenteve në Shërbimin Civil të Kosovës
- Funksionin e vlersimit të rrespektimit të Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës në Autoritetet Punëdhënëse të SHCK

BAZA LIGJORE E VEPRIMIT

Këshilli i Pavarur Mbikqyrës i Kosovës bazën ligjore për ushtrimin e aktiviteteve të veta e ka në legjislacionin pozitiv në Kosovë dhe sidomos në:

Rreg.2001/36 Për shërbimin Civil të Kosovës

UA 2003/2 për Implementimin e rreg 2003/1

Ligjin Mbi proceduarat Administrative(ligji i K.Kosoves nr 02L-28)

U.A. 2005/01 MSHP / Rregullat e Punës të KPMK-së

U.A për rregullat e proceduarve të ankimit në KPMK 2005/2

12 udhëzimet administrativetë MSHP për proceduarat e SHCK

Ligjet e aplikushme në Kosovë sipas rreg,nr1999/24 për Ligjin e aplikueshëm në Kosovë

Përpos kësaj KPMK gjat vizitave monitoruese përdorë edhe pytësorët për zhvillimin e kontrollimeve monitoruese lidhur me pajtueshmërinë e aplikimit të Ligjit të SHCK në A.Punëdhënëse,hartyes i të cilit është vet këshilli.

Gjithashtu palët ankuese jan të obliguara të plotësojnë formën obligatore të ankimit me të gjitha pozicionet e parapara ne te në përputhje me dispozitat e UA 2005/02 për Proceduarat e Ankimit që u Përmbahet KPMK-ja.

Një burim tjetër formal dhe praktik të cilin anëtarët e KPMK e shfrytëzojnë sidomos gjat procedurave të organizimit dhe mbajtjes së seancave dëgjimore me palët prezente është Broshura Udhëzuese e cila u hartua nga KPMK dhe OSBE ,ndersa u diskutua dhe u Aprovua në seminarin organizuar të përbashkët në Ohër të Maqedonisë.

FUNKSIONI I ANKESAVE

Shërbyesit Civil të punësuar në Shërbimin Civil të Kosovës kur konsiderojnë se me ndonjë veprim të Autoritetit të tyre punëdhënës u është shkelë ndonje e drejtë nga marëdhënja e punës kanë të drejtë ti ankohen Këshillit të Pavarur Mbikqyrës të Kosovës.


Kjo e drejtë shërbyesve civil u takon vetem në rstatin kur ata kanë shfrytëzua – shterrë të gjitha mjetet ankimore brenda institucionit ku ata punojne apo kanë punuar.

Po të njejtën drejtë të ankimit pranë KPMK-së e kanë edhe aplikuesit për punë në Shërbimin Civil të Kosovës me kusht që para se të jene ankuar në KPMK të ankohen në komisionin e ankesave të Instucionit ku kanë aplikuar për punë.

Sapo të vijë një ankesë në KPMK ajo rexhistrohet në sekretariatit e tij dhe pas protokolimit procedohet për vendosje ne këshill.

Një komision prej tre anëtarësh i këshillit në emër të këshillit ndërmer të gjitha veprimet procedurale për zgjedhjen e lëndës së ankesës duke përfshire : shqyrtimin e provave të paraqitura në lëndë,organizimin dhe aranzhimin e seancave degjimore,dëgjimin eventual të dëshmitarëve,hartimin e procesverbaleve te seancave dëgjimore,mbajtjen e senacës për këshillim dhe votim dhe përfundimisht nxjerrjen e VENDIMIT për lëndën konkrete të ankesës;(shiko një shembull të ankesës të arritur në KPMK)

QEVERISË SË KOSOVËS
Ministritë për shërbime publike
Këshillit të pavarur mbikëqyrës të Kosovës
Prishtinë



Në afatin e lejuar ligjor , kundër vendimit të Komisionit të Ankesave 02.Nr.07/8638-4 të datës 12.01.2007 ushtrojë këtë :

Ankesë

Për keto shkaqe:

1. Aplikimi i gabuar i dispozitave që dalin nga Qarkorja Buxhetore 2007/05-
3. Vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike.

Arsyetimi

Komisioni i ankesave, fare nuk është lëshuar në vlersimin se a ka pasur të drejtë UD së Drejtorit të QKMF në Ferizaj për largimin tim nga puna, dhe si ka vendosur që të shuaj vendin e punës rojtar , por ma së lehti e ka pasur që të refuzoj ankesën time.

Unë jamë me një përgaditje shkollore që nuk marrë vëhë në shifra, por kur po thuhet se është shkurtuar buxheti –është zvogluar unë po quditem, ne në QKMF kemi marë të pagat nga 130 euro, kurse kompania që e ka fitue tenderin nga QKMF në Ferizaj merë për një punëtor 300 Euro, Komisioni i ankesave këtë faktë nuk e ka marrë fare parasyshtë.

Këtu nuk ka shurje të vendit të punës por këtu ka se në vendin tonë janë pranuar punëtor me lidhje.

Provë: Shkresa Kufit final Buxhetor për vitin 2007.

Se në shërbimin teknik të QKMF në Ferizaj ka nevoj për rojtarë, mirop jo me pagë prej 130 por 300 Euro kushë po fiton nuk ka nevoj me qenë i menqur dhe me e ditë këtë.

Se ketu nuk është vendosur në bazë të kurfarë kriterit por është vendosur pa kriter, vetem te rojtaret, si kategori me e pa shkolluar, këtu është bërë një diskrimin i theksuar dhe shkelje e të drejtave të të punësuarve nga punëdhënsi.

Pse nuk u aplikuen kriteret që i ka caktue Këshilli Ekzekutiv i Komunës së Ferizajit, pse,pse

Unë të 4 kriteret i kamë plotësuar por, pse nuk pati një komision për vlersimin e kriterëve , pse nuk paten mëshirë dhe më banë që unë dhe familja e ime me fëmijë të mitur të dalim në rrugë për të shtri doren e lëmshës, pse nuk i larguan punëtoret që në muajt e fundit i kanë pranuar, por më larguan mue,mëkatë, zoti më ndihmoft mua kurse të pa shpirtit sot i mëshiroftë dhe lëshoftë rrahmet në ta.

Këto kriteret nuk janë aplikue në asnjë moment te rasti i imë, nuk ka pasur kurfar komisioni që do të bante vlersimin - klasifikimin e punëtoreve dhe se kush i plotëson kriteret të mbetet në punë e kushë jotë largohet nga puna.


Provë:Proqesi nga mledhja e Bordit të drejtorve

Duke e luter Perendin, duke e luter shumë KPMK duke besuar se do të doj dhe vlersoj mirë gjendjen time financiare dhe shpirtrore, pasi që të lexoj këtë ankesë, provat e propozuara, shkresat që gjinden në lëndë dhe mua të më degjoj,pastaj të bjenë këtë

V E N D I M

Të aprovoj në tërsi ankesen time si të bazuar, për këthim në vendin e punës, rojtar në QKMF në Ferizaj të më vazhdoj kontratët e punës

Të shfuqizoj vendimin e komisionit të ankesave të KK Ferizaj si të pa bazë
02.Nr.07/8638-4 të 12.01.2007

Ushtruesi i ankesë 
Besim Jetullahu


Talimovci i Mu korherua
ferizaj

TEL 44 - 451 - 235

Në periodën kohore për të cilën raportohet, pra në vitin 2006 në sekretariatit e KPMK-së janë rexhistruar 189 ankesa dhe menjher pas ndërmarjes së proceduarave tekniko –administrative të protokolimit jan proceduar për vendosje ne këshill.

Të ndara sipas përkatësisë nacionale ankesat rezultojnë 186 ankesa tëparaqitura nga ankuesit e përkatësisë nacionale shqiptare dhe 03 ankesa të paraqitura nga ankues të përkatësisë nacinonale sërbe.(shih grafikonin përkatës)


Numri i përgjithshëm i ankesave




Numri i përgjithshëm i ankesave	1	2	3
Shqiptar		186	98.40%
Serb		3	1.53%
Meshkuj		155	82%
Femra		31	16.40%
Të tjerë		3	1.60%

Pas shqyrtimit të plotë të bazave ankimore dhe arsyeve të ankesave KPMK ka konstaar se ankesat kanë për subjekt ankimor:

Ndërprerje të kontratës së punës.....	64 ankesa
Mosvazhdim i kontratës së punës.....	26 ankesa
Kontestim konkursi	50 ankesa
Kompensim material.....	13 ankesa
Degradim nga posti	13 ankesa
Ndrrim të vendit të punës	08 ankesa
Suspendim nga detyra.....	07 ankesa
Masa dicipline.....	04 ankesa
Mospërparim në detyrë.....	02 ankesa
Moszbatim të vendimeve.....	02 ankesa





Pas zbatimit të proceduarve të parapara me ligj komisionet përkatëse të KPMK-së kanë zgjidhur 129 ankesa dhe lidhur me to kanë marrë vendimet meritore dhe ate:


31 ankesa ose 24% janë aprovuar

22 ankesa ose 17.7% janë aprovuar pjesërisht

57 ankesa ose 44.2% janë refuzuar

19 ankesa ose 4.7% janë hudhur poshtë ose janë tërheqë nga ankuesit

shiko grafikonin përkatës



Për të ilustruar formën dhe menyrën e marrjës së vendimeve nga komisionet përkatëse të Këshillitpo prezentojmë dy kopje të vendimeve të marra pas përfundimit të procedurave të parapara me nenin 11 të rreg 2001/36 dhe me metodologjinë e paraparë me Udhëzimin Administrativ 2005/02 MSHP për procedurat e Ankesave të cilave u Përmbahet KPMK

Është e rëndësishme të përmendet se VENDIMIT të marrë i paraprijnë një varg veprimesh procedurale të komisionit i cili është i ngarkuar nga ana e këshillit për vendosjen e lëndës konkrete të ankesës.

Një ankesë e parashtruar në KPMK nga ana e komisionit mundet të vendoset në bazë të shkresave të deponuara në lëndë nga pala ankuese dhe autoriteti punëdhënës vendimi i të cilit atakohet me ankesë.Në këto raste kur ka prova të mjaftueshme komisioni në seancën jopublike për këshillim e votim do të marrë vendimin meritator gjithnjë duke u bazuar ne nenin 5.7 të U.A 2005/02 mbi Procedurat e ankesave në KPMK.

Në rastet kur ka konflikt të fakteve materiale dhe kur komisioni konstaton se është e nevojshme që të organizohet seanca e shqyrtit pregaditor-kryesor për dëgjimin e palëve ,atëherë sekretariati i KPMK ndërmerr të gjitha masat e nevojshme që kjo seancë aranzhohet duke i njoftuar palët për datën dhe vendim e mbajtjes së seancës dëgjimore.(shih fton e nje seance në KPMK)



shiko dy shembuj të ankesave të zgjedhura:

a) shembull kur ankesa e ankuesit është aprovuar

b) shembull kur ankesa e ankuesit është refuzuar



MINISTRIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS MINISTARSTVO JAVNIH SLUŽBI NEZAVISNI NADZORNI ODBOR MINISTRY OF PUBLIC SERVICES INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD	
Nr. Br.	477/06
No.	
Data Datum	21.03.2006
Date	21 st 03 rd 2006 th year
Prishtine Pristina Pristina	



INSTITUCIONET E PËRKOSSHME VETQEVERISËSE
PRIVREMENA INSTITUCIJA SAMOUPRAVE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

QEVERIA E KOSOVES / MINISTRIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
VLADA KOSOVA / MINISTARSTVO JAVNIH SLUŽBI
GOVERNMENT OF KOSOVA / MINISTRY OF PUBLIC SERVICES

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS I KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR KOSOVA

Nr.02/154/2005

Komisioni i KPMK-së në përbërje z.Sevdail Kastrati, kryetar, z.Bahtir Troshupa e z.Bajram Zogiani anëtarë, duke vendosur në çështjen juridike të Ankesës së z.Muhamet Zogaj nga F.Turjakë KKmalishevë të ushtruar kundër A.Punëdhënës KKMalishevë-DKA për shkak të ndërprerjes së Marëdhënjes së punës të rexhistruar në KMPK nën nr 128/05, duke vepruar sipas nenit 11 të rreg.2001/36 mbi SHCK lidhur me nenin 12.2 të UA MSHP 02/2005, pas zhvillimit të seancës së shqyrtimit kryesor me prezencën e palëve në kontest me datë 06.03.2006 nxjerr:

V E N D I M

I. APROVOHET ankesa e ankuesit z.Muhamet Zogaj nga fsh.Turjakë KK-Malishevë.

II. Anulohen vendimi i Komisionit diciplinar mbi shqiptimin e masës diciplinare nr 02/588 dhe vendimi i komisionit të ankesave i KK-malishevë nr 02./680 i dt.19.09.2005.

III. Obligohet A.Punëdhënës që në afat prej 15 ditësh nga dita e marrëjes së këtij vendimi parashtruesin e ankesës Muhamet Zogajn ta kthejë ne punë dhe detyra të punës të cilat i ka krye ne bazë të kontratës së punës.

IV.Për veprimet e ndërmara lidhur me zbatimin e këtij vendimi të njoftohet Këshilli i Pavarur Mbikqyrës i Kosovës

V. Në rast të dështimit të veprimit sipas këtij vendimi KPMK do të veprojë në përputhje me nenin 11.4 të rreg.2001/36 mbi SHCK.

a r s y e t i m

Komisioni i KPMK-së duke elaboruar provat e paraqitura nga të dyja palët dhe duke marrë parasysh faktet e dhëna në seancën kryesore ka konstatuar se:

--Vendimi mbi ndërprerjen e M.P për punëtorin Muhamet Zogaj është marrë mbi bazën e shqiptimit të masës disiplinore për shkak të shkeljes serioze të supozuar e të klasifikuar si mosperfillje detyrës së punës e të cilën ia ka shqiptuar komisioni disiplinor i KK-Malishevës.

- Komisioni disiplinor punëtorit i ka shqiptuar masën më të rëndë disiplinore edhe pse ajo është e paraparë si e fundit dhe me e rënda me nenin 30.2(f).Me Udhëzimin Administrativ MSHP/DASHC 2003/04 mbi **Pocedurat e Disciplinës** hapi 13,pika 13.1.6 thuhet" duhet mbajtur ne mend se rreptësia e masave disiplinore duhet të jetë e barabartë me seriozitetin e shkeljes së rregullave të punës"

Ndërsa në pikën 13.2 të të njetit hap dhe akt juridik thuhet" në përcaktimin e masave më adekuate komisioni duhet të ket parasysht se qëllimi i procedurës disiplinore është të përmirësojë dhe inkurajojë sjellje të mirë dhe të dënojë sjellje të keqe.Veprimet përmirsuese,përfshirë këshillimin, trajnimin dhe zhvillimin duhet normalisht të përfshihen ne rekomandime" e që në rastin konkret nuk ishte përfillur.

- Në deklaratën e vet dhënë pas 11 ditësh nga ndodhja e rastit drejtori i shkollës ka supozuar se roja e natës natën kritike nuk ka qenë fare në punë edhe pse nuk ka ofruar ndonjë provë relavante për këtë pohim e në të kundërtën puntori i larguar ka thënë se natën kritike në mëngjes rrhet orës 5 të mëngjesit ka kërkuar drejtorin e shkollës në shtëpinë e tij për të raportuar për rastin por ai nuk ishte në shtëpi që vërtetonte të kundërtën e pohimit se ai nuk ishte në punë.

_ Komisioni i KPMK konsideron se shkelja e supozuar nuk ka shkatuar dëm të pa kompensueshem për shkollën dhe se komisioni disiplinor nuk ka marrë parasysht faktin se puntori ne fjale nuk ka qene aktor i vjedhjes vetë,dhe nuk ka vlerësuar rrethanat e ndodhjes së vjedhjes(mungesën e rrymës,rrezikun e konfrontimit me vjedhësit dhe vlerën e paisjes së vjedhur) si dhe faktin e egzistimit apo jo të shkeljeve të mehershme disiplinore nga ana e punëtorit në fjalë.

-Komisioni disiplinor nuk ishte themeluar në përputhje me nenin 32.1 të UA 2003/2

-Komisioni i ankesave që ka refuzuar ankesën e z.Muhamet Zogaj nuk ishte formuar në përputhje me nenin 33.2 të të njetit UA.ndërsa me keto dispozita është paraparë që devijimi i parimit të shumllojshërisë nënkupton aplikimin MUTATIS MUTANDIS të dipozitave te nenit 7.3 të UA 2003/2 e KPMK-së nuk iu ofruan prova të jetë vepruar në këtë mënyrë.

Bazuar në gjitha më lartë komisioni i KPMK-së gjenë se me veprimet e veta A.Punëdhënës në rastin konkret ka shkelur parimin udhëheqës (a) të nenit 2.1 të LSHCK andaj edhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike : vendimet e KPMK janë përfundimtare në procedurë administrative andaj kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa por në përputhje me nenin 11.6 të rreg.2001/36 lejohet shqyrtimi procedural i tij.


Vendosur në Këshillin e Pavarur Mbikqyrës të Kosovës lënda nr128/05 dt 12.01.2006.

T'i dërgohet:
z. Muhamet Zogaj, fsh Turjake
KK-Malishevë

komisioni i KPMK-së
Sevdail Kastrati, kryetar

Bahtir Lleshi, anëtar

Bajram Agiani, anëtar





MINISTRI I SHËRBIMEVE PUBLIKE
MINISTARSTVO JAVNIH SLUŽBI
MINISTRY OF PUBLIC SERVICES

Nr. 2061/06
Data 22.12 2006 god
Datum 22.12 2006 god



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE
PRIVREMENA INSTITUCIJA SAMOUPRAVE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

QEVERIA E KOSOVËS / MINISTRIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
VLADA KOSOVA / MINISTARSTVO JAVNIH SLUŽBI
GOVERNMENT OF KOSOVO / MINISTRY OF PUBLIC SERVICES

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS I KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR KOSOVO
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD KOSOVO**

A, 02, 146/2006

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës i Kosovës - Komisioni për shqyrtimin e ankesave, në këtë përbërje: Bisera Spahi kryetare, Nebojsa Azdejković anëtar dhe Mursel Ahmeti anëtar, duke vepruar sipas ankesës nr. A02, 146/2006 e datës 5.10.2006, e ankuesit Azem Kastrati nga Peja rr. "Afrim Xhuraj", nr.11 Zyrtar i Administratës Tatimore të Kosovës –MEF-i , kundër vendimit të Komisionit për ankesa – Organi Punëdhënës "Administrata Tatimore të Kosovës – MEF-i ", në bazë të Rregullores së UNMIK -ut, nr. 2001/36, neni 11.1 dhe Udhëzimit Administrativ të MSHP, 2005/2, neni 12.3, merr këtë:

V E N D I M

1. REFUZOHET ankesa e ankuesit, nr. A, 02 146/2006 e datës 5.10.2006, e Azem Kastratit nga Peja, rr. "Afrim Xhuraj", nr. 11, Zyrtar i Administratës Tatimore të Kosovës- MEF-i si e pabazuar.
2. Vërtetohet vendimi i Komisionit të ankesave nr. 11 07/109 i datës 31.8.2006 Administratës Tatimore të Kosovës-MEF si i ligjshëm.
3. Vendimi i Komisionit për ankesa i KPMK-së, t'i dërgohet:
 - Organit Punëdhënës "Administratës Tatimore të Kosovës"- MEF-i,
 - Ankuesit,
 - Në dosjen e kësaj lënde.

Ar sy e t i m

Komisioni për ankesa i KPMK-së e ka shqyrtuar ankesën, provat ankimore, provat e ankuesit, shkresat e paraqitura të lëndës si dhe deklaratën e ankuesit dhe Organit punëdhënës në seancën e mbajtur më 20.12.2006.

Ankuesi i ankesës A 02/146/2006 e datës 5.10.2006 Azem Kastrati, ka punuar si Administrator i sistemit dhe bazës së të dhënave në Zyrën qendërore në ATK. Me vendimin e Drejtorit të ATK-së, të datës 13.6.2006, ankuesi është transferuar në pozitën Administratorit të sistemit dhe bazës së të dhënave në zyrën rajonale në Prishtinë II , lokacioni është në ndërtesën e njëjtë. Vendi i ri i punës është në nivelin e njëjtë, sipas përgatitjes profesionale dhe pagën e njëjtë sikur ajo e mëparshmeja.

Pasi që nuk është pajtuar me vendimin mbi transferimin dhe mospranimin e vendit të ri të punës, ankuesi ka paraqitur ankesën komisionit për ankesa në ATK. Me 13.7.2006, komisioni për ankesa e ka refuzuar ankesën e tij si e pabazuar , ku baza për refuzimin e ankesës së ankuesit është moszbatimi i vendimit ligjor, i cili është marr në përputhje me nenin 11. "Lëvizshmëria" të U. A. 2003/02.

Vendimi i komisionit për ankesa të organit punëdhënës nr. 11 07/109 i datës 31.8.2006 të Administratës Tatimore të Kosovës/MEF-i vërtetohet si i bazuar dhe është marrë në përputhje me Urdhëresën Administrative nr. 2003/2 (Kapitulli III) neni 11.1 mbi zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/36 ku thuhet:

"Kur kërkojnë nevojat e Shërbimit civil, nëpunësit civil mund ricaktohen në poste të tjera në nivelin dhe shkallën e njëjtë të pagës nga organi punëdhënës, me kusht që posti ri të përputhet me përgatitjet dhe aftësitë e tyre profesionale. Ricaktimet e tilla mund të përfshijnë lëvizjen në një lokacion tjetër , me kusht që të lejohen mjete të arsyeshme për rrethanat personale."


Në bazë të gjendjes juridike dhe faktike, Komisioni për ankesa KPMK-ës merr vendim si në dispozitiv .

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative. Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.

Është vendosur në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës në Prishtinë, lënda, nr.02/146/2006 më 22.12.2006.

Komisioni i KPMK:

1. Bisera Spahi, kryetar
2. Nebojsa Azdejkovic, anëtar
3. Mursel Ahmeti, anëtar




Përktheu:
Shemsedin Mujko
Më, 22.12.2006 *Sh.M. Mujko*

IMPLEMENTIMI(ZBATIMI) I VENDIMEVE TË KPMK-së

Vendimet e KPMK-së janë të obligueshme për tu zbatuar nga organet punëdhënëse në Shërbimin civil të Kosovës. Sipas nenit 11.3 të rreg.2001/36 përgjegjës për zbatimin e VENDIMEVE të KPMK-së janë sekretarët e përhershëm të Ministrive dhe Përgjegjësit kryesor të Organit të punësimit përkatës(kryeshefat ekzekutiv).

Nga 129 vendime të marra gjat vitit 2006, 119 nga to janë zbatuar,3 pas vizitave të bëra në Autoritetet Punëdhënëse dhedhenjes së shpjegimeve plotësuese për pasojat e moszbatimit të vendimeve të KPMK-së janë në procesin e implementimit dhe 7 nuk janë zbatuar(shiko grafikunin përkatës)



Në rastet kur organi i punësimit dështon të zbatojë **vendimin** e këshillit,këshilli menjëher lajmëron PSSP dhe Kryeministrin(neni 11.4 i të njetës rreg)

(shih kopjen e nje njoftimi)



1507/06
01.09.2006



INSTITUCIONET E PËRKOQSHME VETQEVERISËSE
PRIVREMENA INSTITUCIJA SAMOUPRAVE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

QEVERIA E KOSOVES / MINISTRIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
VLADA KOSOVA / MINISTARSTVO JAVNIH SLUŽBI
GOVERNMENT OF KOSOVA / MINISTRY OF PUBLIC SERVICES

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS I KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR KOSOVA

Për Z.Agim Çeku, Kryeministër i Qeverisë së Kosovës
Nëpërmes Z.Fitim Krasniqi Sek. Permanent
Nga: Sevdail Kastrati, kryetar i KPMK-së

Lënda: Informatë

I nderuar Kryeministër në duke u bazuar në nenin 11.4 të Rreg 2001/36 mbi Shërbimin civil të Kosovës, e me qëllim të informimit të ndërsjellë ju informoj si më poshtë:

Këshilli i Pavarur Mbiqyrës duke ushtruar funksionin e tij të zgjedhjes së ankesave të shërbyesve civil sipas nenit 11 të rregullorës së sipër përmenduar ka zgjedhur deri me tani 201 ankesa dhe shumica absolute e tyre janë implementuar nga Autoritetet punëdhënëse në Shërbimin civil të Kosovës,

Por në kohën e fundit janë disa vendime që nuk janë implementuar dhe konkretisht si më eklatante janë vendimi nr 169/2005 i cili ka të bëjë me Komunën e Mitovicës me të cilin KK është urdhëruar ta rishpallë konkursin për pozuitën e kryeshefit ekzekutiv shkaku i lëshimeve procedurale të konstatuara me rastin e realizimit të këtij konkursi dhe ,rasti i dyte ka të bëjë me Komunën e Vushtrrisë ku nuk janë implementuar vendimet e KPMK-së nr 17.18.19.20/2005 (të bashkuara në një lëndë me vendim të këshillit dhe ku është njerrë një vendim) dhe vendimi nr 02/16/2005 me të cilat vendime janë APROVUAR ankesat e ankuesve dhe KK-Vushtrri është obliguar t'ua njohë të gjitha të drejtat nga M.Punës sipas kontratave valide të punës.

Konsiderojme se moszbatimi i vendimeve të Këshillit pos që është shkelje e dipozitave të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Kosovës, është edhe shenjë jo e mirë për parimin e sundimit të ligjit në shoqëri.

Duke qenë se sipas Ligjit jeni ju garantues i zbatimit të VENDIMVE të Këshillit të Pavarur, sinqerisht ju lus që të ushtroni angazhimin tuaj për zbatimin e këtyre vendimeve.

Duke ju falenderuar paraprakisht për mbështetjen për KPMK ju përsërisht dhe ripërsërisht gadishmërinë e Këshillit për bashkpunim në të gjitha fushat ku shifet e nevojshme nga ana e juaj në intres të përgjithshëm të krijimit të një Shërbimi Civil efikas, profesional me veprime të bazuara në ligj dhe mbi të të gjitha në shërbim të qytetarëve të Kosovës.

Një kopje e këtij raporti i dërgohet Kryeministrit dhe PSSP.

Shtojcë: kopjet e vendimeve

Me respekt: Sevdail kastrati



Nga tabela e mësipërme vërehet se vendimet e Këshillit në masë ma të madhe zbatohen por ka edhe raste kur ato për arsye jo bindëse e të pajustificueshme nuk

zbatohen ose zvariten për kohë më të gjatë me qëllim që me kalimin e kohës të bëhet i pamundëshëm zbatimi i tyre.

Cilat janë organet punëdhënëse që nuk i kanë zbatuar vendimet e KPMK-së:

Komuna e Vushtrisë nuk ka zbatuar dy vendime të KPMK-së

Komuna e Ferizajit nuk ka zbatuar një vendim të KPMK-së

Komuna e Gjilanit-Qendra e Mjesisë Familjare nuk ka zbatuar 2 vendime

Komuna e Mitrovicës nuk ka zbatua 1 vendim të KPMK-së

Ministria e Punës dhe Miqenjës Sociale nuk ka zbatua 1 vendim të KPMK-së



Autoritetet punëdhënëse që janë shumë kooperative në zbatimin e vendimeve të KPMK-së janë:

Komuna e Prishtinës, Komuna e Malishevës, Komuna e Shtimes, Ministria e Punës, Ministria e Bujqësisë etj. (shiko shembullin e një njoftimi nga autoriteti punëdhënës për zbatimin e vendimit të këshillit).

Kuvendi Komunal në Malishevë

Shefi Ekzekutiv

Nr. 02/175



Nga : Shefi Ekzekutiv, Ism Kilaç eedip.

Për : Ministrin për Shërbime Publike
Këshillit të Pavarur Mbrojtës të Kosovës
z. Sedat Kastrati - Kryetar

Datë : 20.04.2006

Lënda : N j o f t i m

Endetuar z. Kastrati,

Duke marrë për bazë shkresën tuaj nr.477/06, të datës,21.03.2006, në lidhje me Vendimin, me të cilin aprovohet ankesa e z. Muhamet Zogaj nga fshati Turjakë KK- Malishevë, në lidhje me anulimin e Vendimit të Komisionit të Ankesave të KK-së Malishevës nr.02/680, i datës 19.09.2005, ju informoj se:

Marrë për bazë Vendimin tuaj, z. Muhamet Zogaj, është kthyer në punë dhe detyra të punës, të cilat i ka ushtruar para se të merret kjo masë, nga organet kompetente komunale.

Nga se re tha në mbesim të hapur për bashkëpunim të mërutjeshëm.

Ndihmo te sigqerta,

Sipas nenit 11.6 të po kësaj rregulloreje vendimi i KPMK-së konsiderohet si përfundimtar në procedurë administrative dhe duke u bazuar në Ligjin mbi Konfliktet Administrative si i tillë do të mund të apelohej vetëm Gjykatën Supreme të Kosovës e cila do të vlerësonte ligjshmërinë e vendimit.

Në esence në këtë drejtim ka disa moskuptime sepse Gjykata Supreme pranon paditë e parashtruara nga Palët e paknqura për konflikt administrativ por pastaj i kthen në Gjykatat Komunale ku në shumicën e rastev po ata gjykata më parë janë shpallur jo kompetente për të vendosur lidhur me të njëjtat lëndë. Kjo konsiderojmë se është një verprim i paarsyeshëm dhe që shkon në dëm të palëve duke krijuar vonesa të pajustificueshme .

FUNKCIONI I SHQYRTIMIT TË EMËRIMEVE NË NIVEL TË UDHËHEQËSVE TË DEPARTAMENTEVE NË SHCK.

Funksioni i i dytë i këshillit është shqyrtimi i emërimeve të shërbyesëve civil në nivelin e Udhëheqësëve(drejtorëve) të Departamenteve në Shërbimin Civil të Kosovës.

Ky funksion është i paraparë me nenin 12.të rreg.2001/36 për SHCK dhe me këtë parashihet obligimi i KPMK-së që me nje komision të caktuar nga këshilli të vëzhgojë procedurën e zgjedhjes së drejtorëve të departamenteve në të gjitha organet punëdhënëse të Shërbimit Civil të Kosovës.Në të njëjtën kohë organet punëdhënëse në SHCK janë të obliguara që të njoftojnë me kohe për kohën e mbajtjes së intervistës për plotësimin e vendeve të punës së drejtorëve të departamentit dhe që komisionit të caktuar për vëzhgim të KPMK-së ti japin tërë dokumentacinin e nevojshëm lidhur me veprimet procedurale të ndërmarra nga organi punëdhënës për rastin konkret.

Organet punëdhënëse në SHCK në shumicën dërmuese të rasteve përmbushin obligimin ligjor dhe ftojnë KPMK-në të vëzhgojë procedurën e zgjedhjes së drejtorëve të departamenteve,dhe e vetmja ngecje në këtë drejtim i referohet komunave të veriut të Kosovës Laposavicit,Zubin Potokut dhe Zvecanit ndersa ne nje rast edhe Komuna e Prizerenit ka dështuar ta njoftoje kPMK-në me kohë për datën e mbajtjes së intervistës për Drejtor të Departamenteve.(shih dy kërkesa për vëzhgim procedure të emrimit të drejtorëve të departaneteve)



INSTITUCIONET E PËRKOQSHME TE VETËQEVERISJES
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo za Kultururu, Omladinu i Sport
Ministry of Culture, Youth and Sports
048/2006
07.09.2006
F.Hoxha

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT
MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORT
MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORTS

Departamenti i Administratës Qendrore
Departman Centralnog Administracije

07.09
1853/06

Për/ Za/ To:	Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës - MSHP
Përmes /Preko / Through	znj. Zana Kryeziu Sekretare e Përhershme, MKRS z. Abdurrahmon Zhubi, Drejtor i Departamentit të Administratës Qendrore
Nga/ Od/ From:	Znjsh. Minire Zeka Menaxhere e Personelit, DAQ
Tema/Subjekat/Subject:	Njoftim
Data/ Datum/ Date:	07.09.2006

Të nderuar,

Ftoheni të merrni pjesë si vëzhgues në zgjedhjen e këtij konkursi për pozitën, "Drejtor i Departamentit të Çështjeve Jo Rezidente", të hënën më 11/09/2006, kati i parë, nr 116, në ora 10.00.

Ju lutem konfirmoni ardhjen tuaj.

Me respekt,

MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORTS

DEPARTMENT OF CENTRAL ADMINISTRATION

Postal address: Nena Tereze #35, Prishtinë, Kosovë (office no. 023)

Tel: +381 38 211 529 (centrex: 22 564)

Fax: +381 38 211 526

E-mail: minire.zeka@ks-gov.net

№ 02102/7B

Data: 23.01.07.



**Kuvendi Komunal/Skupstin Opstina
Novobërdë/Novo Brdo**

OPSTINA NOVO BRDO

Za: NNOK – Nezavisni Nadzorni Odbor Kosova

Od: Sretena Ivanovica, Izvrshnog Nacelnika Opstine Novo Brdo



REPUBLIKA KOSOVO KOMUNALNA UPRAVA NOVO BRDO	
23.01.2007	
Z	
1	
Sretena Ivanovica	

Predmet : Poziv

Tema : Intervju za Direktore Direktorata I Zamenike Direktora

Postovani,


Obzirom da ste upoznati da je prvi konkurs za Direktore Direktorata I Zamenike Direktora u Opstini Novo Brdo ponisten iz razloga sto Izborna komisija nije nasla 3 kandidata koji bi mogli uci u uzi izbor, pojedini zainteresovani kandidati nisu ispunili trazene kriterijume, pa smo otvorili drugi konkurs koji ce trajati do 29. Januara 2007. godine do 16⁰⁰ casova.

Na osnovu Uredbe br.2001/36 clan 12. o Javnim Sluzbama na Kosovu, I na osnovu Administrativnog upustva 2001/3 o proceduri regrutacije, pozivam Vas da dana 01. Februara 2007. godine u 10⁰⁰ casova, dodjete kao Komisija posmatraca na zakazani intervju.

S' postovanjem.

Dana : 23.01.2007.
U Novom Brdu

Duke ushtruar këtë funksion KPMK ka realizuar 56 vizita vëzhguese në gjatë të cilave është monitoruar procedura ligjore e zgjedhjes së 84 drejtorëve të departamenteve.(shih diagramin e mëposhtëm)



Menqenëse është viti i dytë me radhë që KPMK e ushtron veprimtarinë e vet dhe që rregullisht merë pjesë në vëzhgimin e këtyre emërimeve, mund të konkludojmë se kryesisht procedurat e parapara me ligj zbatohen. Mirpo ka edhe rasti kur për shkak të lëshimeve proderuale KPMK rekomandon vazhdimin e aftit të konkurimeve edhe për 15 ditë tjera apo kur ky afat ka kaluar edhe ripërsëritjen e konkursit. Një rekomandim i tillë është bërë në 18 raste dhe të gjitha rekomandimet janë përfillur.

Rekomandimi për zgjatjen e aftit të konkurimit të kandidatëve apo edhe ripërsëritja e konkursit është bërë kryesisht për dy shkaqe.

Mos publikimit të konkursit në përputhje me nenin 4.1 të UA2003/2 dhe përmbushjen ekritereve të parapara me nenin 4.2 të të njejtës urdhëresë Administrative lidhur me përfaqësimin gjinor e etnik në shpallje.

Një rekomandim i tillë është dhënë edhe në rastet kurë komisioni intervistues nu ka qenë i komponuar në përputhje me dispozitën e nenit 7.2 të UA 2003/2 ndërsa autoriteti punëdhënës nuk ka ofruar prova për Komisionin e KPMK-së se ka bërë përpjekjet e duhura për ta komponuar një komision të tillë dhe të ketë ndërmarrë veprimet e parapara me nenin 7.3 të të njejtës Urdhëresë Administrative që një proces të tillë do ta bënte të ligjshëm.

Nga rastet të rekomandimeve për ripërsëritjen e konkursit-shpalljes po përmendim:Konkursain e KK-Kamenicë për zgjedhjen e të gjithë drejtorëve të Drejtorive Komunale,Konkursiet në Ministrinë e Kulturës ,Rinisë dhe Sporteve,Ministrinë e Trgtisë dhe Industrisë,Ministrinë e Kthimit dhe Komuniteteve, Ministrinë e Bujqësisë, Min. E Shëndetësisë etj.

Ntyrisht se i takon komisionit intervistues të A.Punëdhënës të zhvillojë procedurën e intervistimit dhe të marrë një vendi meritore për kandidatët që duhet të zgjidhen ne postin e shpallur,por roli i KPMK-së është që të sigurojë edhe kandidatët që kan konkurua e edhe publikun e gjerë se procedurat e parapara me ligj janë rrespektuar dhe sidomos parimi udhëheqës i MERITËS i LSHCK i paraparë me nenin 2.1 të rreg.2001/36.

Pas vëzhgimit të procedurës së zgjedhjes së drejtorëve të departmantit në një autoritet punëdhënës ,komisioni i caktuar nga këshilli i referon me RAPORT të shkruar Këshillit dhe Këshilli në pëputhje procedurat e parapara me rrgulloren për punën e tij merr një VENDIM meritore për raportin.

Në rast se Këshilli duke u bazuar në raportin e komisionit të tij **konstaton** se gjat këtyre procedurave zgjedhore jan shkelur parimet udhëheqëse të Shërbimit Civil të Kosovës, ai menjëherë lajmëron Kryeministrin dhe PSSP-në. (shiko nje kopje të një raporti të komisionit vëzhgues të paraqitur për aprovim në KPMK-)



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETQEVERISËSE
PRIVREMENA INSTITUCIJA SAMOUPRAVE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

QEVERIA E KOSOVES / MINISTRIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
VLADA KOSOVA / MINISTARSTVO JAVNIH SLUŽBI
GOVERNMENT OF KOSOVA / MINISTRY OF PUBLIC SERVICES

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS I KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR KOSOVA

Në bazë të nenit 12 par 1.pika(a dhe b) të rreg 2001/36 për SHCK .pas përfundimit të vëzhgimit të procedurës të zgjedhjes së drejtorit të dep.të Industrisë,Tregtisë dhe Ndërtimtarisë.Komisioni i KPMK-së në përbërje Sevdail Kastrati.kryetar, Nebojsa Azdejkovic dhe Bahtir Troshupa ,anëtarë Këshillit i paraqet:

R A P O R T

PËR VËZHGIMIN E PROCEDURËS SË ZGJEDHJËS TË DREJTORËVE TË DEPARTAMENTEVE TË INDUSTRIË,TREGTISË DHE NDËRTIMTARISË NË MINISTRINË E TRGTISË DHE INDUSTRIË

Materiali i ofruar për KPMK-Dosja complete e regrutimit:

Kopja e konkursit dhe e konkursit të rishpallur në tri gjuhë
Vendimi për komisionin intervistues
Lista e kandidatëve që kan konkurua
Lista e kandidatëve të seleksionuar për intervistim
Fletaplikacionet e kandidatëve që intervistohen

Pas kontrollimit të dosjes së ofruar komisioni i KPMK-së konstaton:

Me rastin e kontrollimit të parë të dokumentacionit u konstatua:
Konkursi ishte shpallur ne mediat përkatëse dhe ne gjuhët e parapara me ligj dhe se ishte vazhduar për 15 ditë me ndërhyrjen e KPMK-së

Komisioni kishte përcaktuar kriteret e intervistimi

Komisioni intervistues ishte formuar në përputhje me nenin 7,3 të UA 2003/2 dhe përbëhej nga: Adem Zogiani ud i sek permanent, Xhevat Bekteshi drejt i dep. të Metrologjisë, Avdullah Haxhiu. zv. dert. i dep. te Admin. Resmije Mumxhiu drejt e Admin, ne MEM. dhe Hafiz Gara . kryeshef i Agje, të Standarnizimit.

Pozitat e shpallura :Drejtor i Departamentit të Industrisë ,dep. të Tregtisë dhe të Dep. të Ndërtimtarisë.

*Pas kontrollit të dokumentacionit komisioni i KPMK-së konstatoi
Se janë përmbushur të gjitha kushtete për mbajtjen e intervistës
RRJEDHA E INTERVISTËS*

Vendi i mbajtjes së intevistës ishte i përshtashëm
Kandidatëve iu parashtruan për afërsisht të njëjtat pyetje
Kandidatët kishin kohe të njëjtë në dispozicion për intervistim
Atmosfera e përgjithëshme e qete, relaksuese dhe tolerante

Konstatimi i përgjithëshëm

**PROCEDURA E ZGJEDHJE SË KANDIDATIT PËR POZITËN E
DREJTORËVE NË MINISTRINË E TREGTISË DHE INDUSTRIË
ISHTE NË PËRPUTHJE NENIN 2.1 TË LSHCK(2001/36)**

Komisioni i KPMK-së

1. Sevdail Kastrati, kryetar

2. Nebojsa Azdejkovic, anëtar

3 Bahtir Troshupa, anëtar

Edhe pse me Rregulloren për Shërbimin Civil të Kosovës (neni 1) janë të përkufizuar si shërbyes civil drejtorët e departamenteve të Ministrive dhe Agjensioneve Ekzekutive kanë dallime në menyrën e zgjedhjes nga drejtorët e departamenteve të Komunave të Kosovës .

Të parët zgjedhen sipas procedurave të përgjithshme të parapara me LSHCK dhe UA 2003/2 ndërsa Drejtorët e dep.të Komunave kanë një karakteristikë sepse kanë edhe akt juridik më shumë në përdorim ekjo është rreg,2000/45 Vetëqeverisjen E Komunave dhe involvimin e Asambleve Komunale në këtë proces. (neni 31 i kësaj rregulloereje)

Sidoqoftë komisioni vëzhgues i KPMK-së i ka parasyshë specifikat e rastit dhe gjithmonë kujdest për ligshmërinë e procedurës të vëzhguar.

FUNKSIONI I VLERËSIMIT TË RRESPECTIMIT TË LIGJIT

Një administratë funksionale,transparnete,efikase ,gjithpërfshirëse,në shërbim të të gjithë qytetarëve të vet mund të përmbush objektivat e veta vetëm nëse funksionon në bazë të ligjeve pozitive dhe nëse zbatimin e ligjeve e ka imperativ.

Funksioni i vlersimit të zbatimit të ligjit nëpër Autoritetet Punëdhënëse të SHCK,apo funksioni i tretë i KPMK-së e ka pikërsht këtë qëllim.Duke kryer vizitita kontrolluese ,duke shqyrtuar të dhënat e punësimit në dosjet personale,duke percjellur procedurat e rekrutimit në SHCK,këshilli kujdeset që parimet udhëheqëse mbi bazën e të cilave Shërbimi Civil i Kosovës është ngritur edhe të jenë përdihmëri reale dhe jo fikson i imagjinuar i të së ardhmës.

Në këtë drejtim KPMK tashmë është organ i cili plotësisht funksional dhe apolutisht i përkushtuar për mbikqyrje efektive të SHC gjithnje duke u bazuar në norma ligjore dhe duke aplikuar metoda të njohura ,të aplikueshme edhe ne organet si KPMK-ja në Angli.Shqipëri,Kanada e tj.

Funksionin e vlerësimit të rrespektimit të Ligjit të Shërbimit Civil ,këshilli për vitin 2006 e ka zhvilluar në përputhje me planin për vizitat monitoruese-kontrolluese që do të beheshin në organet punuese të Shërbimit Civil të Kosovës.

Ndërsa i tërë procesi i zhvillimit ë kontrollimve bazohej në **pytësorin unik** i cili në vete ngerthen aktivitetet që ndërmerren ,dokumentacionin që kërkohet të kontrollohet,personat që kontaktohen etj.

Pytësori përmban tri faqe të shkruara dhe është dokument gjenerik i Këshillit i cili si tillë ka shërbyer edhe si udhërrëfytes për përcjelljen e aktiviteve të caktuara në SHCK edhe për organe tjera që merren me Shërbimin Civil si DASHC i Ministrisë së Shërbimeve Publike dhe ekipeve komunale të OSBE-së

Në Ministri, Agjensione Ekzekutive dhe në Komunat e Kosovës për të konstatuar gjendjen reale në këtë lami këshilli është prezenentuar me dy anëtarë të vet dhe me asistencen e plotë të zyrtarës për monitorim nga sekretariati i Këshillit.

Për këtë qëllim janë kryer :

57 vizita monitoruese ne Autoritetet punëdhënëse dhe ate:

Ministri 14 vizita

Agjesinone Ekzekutive 6 vizita

Kryeministri 1 vizitë

Kuvend të kosovës 1 vizitë

Komuna 27 vizita

ATK 1 vizitë

Spitale regjionale 1 vizitë

QKUK 1 vizitë

Univerziteti i Prishtinës 1 vizitë

Qendra e Studentëve 1 vizitë

Gjat procesit të monitorimit KPMK ka konstatuar se në krahasim me vitin paraprak është bërë përparim në zbatimin e proceduarve të parapara me rreg.2001/36 por akoma ka raste ku ka sfera që duhet të përmirësohen dhe për këto Këshilli ka lëshua 51 raporte me rekomandime për përmirsimin e veprimeve të caktuara.

Rekomandimet kanë të bëjnë kryesisht me këto fusha:

Mos emrimi menaxherit të personelit 1 rast

Mos bartja e kompetencave menaxherit të personelit... 7 raste

Kohëzgjatja e kontratave të punës në kundërshtim me ligjin...2 raste

Moskompletimi i dosjeve personale..... 17raste

Mosmbulimi i dosjeve personale të shëndetësisë dhe arsimit nga ana

e autoriteteve të komunës. 16 raste

të meta në zhvillimin e procedurave të konkursit..... 08

(shiko nje raport me rekomandimin përkatës)



INSTITUCIONET E PËRKOHËSHME VETËQEVERISËSE
PRIVREMENA INSTITUCIJA SAMOUPRAVE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

QEVERIA E KOSOVËS / MINISTRIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
VLADA KOSOVA / MINISTARSTVO JAVNIH SLUŽBI
GOVERNMENT OF KOSOVA / MINISTRY OF PUBLIC SERVICES

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS I KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR KOSOVO
INDEPEDENT OVERSIGHT BOARD KOSOVO**

VLERËSIMI I RESPEKTIMIT TË LIGJIT

KOMUNA E SHTIMES

TË DHËNA MBI VIZITËN

1. Anëtarët e Këshillit: Mursel Ahmeti
Bisera Spahi




2. Data: 23.05.2006.

Personi me të cilin kemi kontaktuar: Znj.Ibadete Kurtaliqi – Menaxhere i
Personelit dhe Feride Rexhej Asistente Administrative

PJESA E PARË: KONKLUZAT

• TË DHËNAT THEMELORE

1. Menaxherja e personelit është emëruar dhe janë bartur të gjitha përgjithësitë.
2. Sektori i Arsimit i ka 464 të punësuar, derisa Shëndetësia 76 punëtorë.
3. Administrata e komunës së Shtimes i ka 108 punëtorë duke përfshirë QKRC, zjarëfikësitë dhe Zyrën për Kthim.
4. 85 janë meshkuj dhe 23 femra.
5. 105 janë shqiptarë dhe të tjerë 3.
6. E kanë të punësuar një nëpunës me aftësi të kufizuara.

• TË DHËNAT E PUNËSIMIT

1. Në dokumentacion ekzistojnë të dhënat e punësimit të punëtorëve në Administratën e komunës.
2. Informatat e të dhënave për punëtorë i plotësojnë nevojat themelore, në bazë të Ligjit.
3. Për administratë Komunale të dhënat e punësimit janë në vend të besueshëm.
4. Të dhënat për Shëndetësi janë të vendosura në QMF, ndërsa të dhënat e Arsimit gjinden nëpër shkolla.

• PROCESI I REKRUTIMIT

1. Procesin e rekrutimit e ndërmerr Udhëheqësi i drejtorisë dhe procesi i mëtejme zbatohet nga Zyra e Personelit.
- 2.

- **KONTRATAT**

1. Të gjithë nëpunësit i kanë kontratat.
2. Kontratat i nënshkruan Menaxheri i Personelit.
3. Vazhdimi i kontratave bëhet me Aktvendim dhe mendojmë se nuk është në rregull sepse me rastin e vazhdimin duhet të hartohet kontratë e re dhe të në shkruhet nga punëdhënësi dhe i punësuar.

- **PUSHIMET MJEKËSORE**

1. Dokumentacioni i pushimeve mjekësore është në rregull.

- **MUNDËSITË E BARABARTA**

1. Informatat të cilat i kemi marr, janë të mjaftueshme që të konstatohet se ekziston strategjia mbi mundësitë e barabarta dhe koordinim në mes Zyrës së Personelit dhe të Zyrtarit për barazinë gjinore dhe mundësitë të barabarta.

- **PROCEDURAT DISIPLINORE
DHE KOMISIONET DISIPLINORE**

1. Komisioni disiplinor funksionon në bazë të ligjit.
2. Kanë pasur nëntë raste për shqyrtim nga të cilat shtatë raste janë cilësuar si shkelje të lehta dhe dy raste janë përcjell komisionit disiplinor për shqyrtim.

- **KOMISIONI I ANKESAVE**

1. Emërimi i Komisionit për ankesa është formuar në bazë të ligjit. Deri tash kanë shqyrtuar një ankesë.

- **TREGUESIT TJERË:**

1. Regjistri i ardhjes në punë është në rregull dhe gjendet në Zyrën e Personelit.
2. Ekziston programi i qartë për trajnime, çdo drejtori e harton programin dhe i'a dorëzon Menaxherit të Personelit.
3. Vlerësimi i periudhës provuese zbatohet në formën e paraparë.
4. Kanë koncept të qartë mbi konceptin e konfliktit të interesit.

PJESA E DYTË - REKOMANDIMET

- **KOMENTET E PËRGJITHSHME**

1. Komisioni i KPMK-ës konsideron se Njësia e Personelit ka staf profesionalisht të aftë, të trajnuar dhe kushte mjaft të mira të punës. Zyra është e pajisur me internet, telefon dhe pajisje tjera të nevojshme.
2. Në bazë të shqyrtimit të përgjithshëm dhe shikimin e dokumentacionit , komisioni konsideron se ekzistojnë fushat në të cilat janë të nevojshme përmirësimet.

• **REKOMANDIMET E VEÇANTA**

1. Të dhënat për Sektorin e Arsimit duhet të koncentrohen në një vend- mundësisht në ndërtesën komunës- Drejtorinë e Arsimit.
2. Numri i femrave, numri i minoriteteve dhe persona me aftësi të kufizuara në shërbimin publik të Komunës së Shtimes duhet të rritet.
3. Vazhdimi i kontratave të punës të bëhet me kontratë të re e jo me Aktvendim siç është praktik e deritanishme.

Nga fushat të cilat gjatë vizitave monitoruese janë cilësuar se duhen përmirsimet karakteristike janë psh : kohëzgjatja e kontratave të punës për drejtorët e Komunës së Pejës në 4 vite edhe pse ata janë shërbyes civil dhe me neni 3.3 të rreg.2001/36 parashifet kohëzgjatja e kontratave të punës deri në tri vite,e njeta gjendje është në Universitetin e Prishtinës për Profesorët Universitar. Kryeshefat ekzekutiv në disa komuna akoma nënshkruajnë kontratat e punës (psh, KK-Kamenicë, Obiliq etj) duke mos e bartë këtë përgjegjësi tek menaxherët e personelit të cilët sipas ligjit janë organ i emërimit dhe natyrisht që kryeshefat ekzekutiv janë zyrtarët më të lartë egzekutiv dhe aporovues dhe nënshkrimi i kontratave nga menaxherët e personelit është më shumë çështje teknike se sa substanciale, në dosjet personale ka mungesa të dokumentacionit personal në bazë të të cilit do të përcaktohej mosha e shërbyesit civil dhe statusi i banorit të Kosovës e që lidhen me pensionimin e shërbyesit civil dhe fitimin e statusit të shërbyesit civil.

Duke u bazuar në rekomandimet e vazhdueshme të këshillit në çështjen e mbulimit të dosjeve personale të të punësuarve në arsim dhe shëndetësi ku juridikisht Komuna ka statusin e punëdhënësit janë bërë përarime të dukshme. Në shumicën e komunave në këto dosje tashme kanë çasje menaxheret e personelit të komunave por akoma ka komuna ku kjo nuk ka mundur të behet.

Arsyetimet janë kryesisht të natyrës teknike si mungesa e sipërfaqës për ruajtje për dosje, apo pamundësia teknike e transferit të tyre.

Gjatë vëzhgimit të rasteve të proceduarve disiplinore në Organet punëdhënëse të shërbimit civil janë vërejtur përpërime të dukshme në udhëheqjen e proceduarve disiplinore në mënyrë kualitative. Komisionet disiplinore në më pak raste shqitojnë masën disiplinore "**ndërprerje e marrëdhënës së punës**" dhe orientohen për shqitimin e masave më të buta disiplinore.

Këshilli në 4 raste (dy Ministria e Bujqësisë, një në KK-DKA Istog, një në MTPT) ka konstatuar se shqiptimi i masës disiplinore është bërë duke anashkaluar dispozitat ligjore dhe me vendim ka urdhëruar në tri raste anulimin e masave disiplinore ndërsa në një rast ripërseritjen e procedurës. (të gjitha janë zbatuar)

Çështje tjera të konstauara të vlefshme për tu veçuar janë, në momentin e vizitës psh: në KK-Prizeren drejtorët e drejtorive komunale punonin me kontrata të skaduara të punës ,Ministria e Punëve të Brendshme akoma nuk kishte emëruar menaxherin e personelit dhe formuar komisionin dicitlinor e të ankesave,në Ministrinë e arsimit sekretari permanent vendoste për ankesat e shërbyesëve civil në shkallë të fundit,në dosjet personale të shërbyesëve civil të Ministrisë së drjetësisë kishte raste të mungesës të dokumentacinit personal etj e të gjitha këto u përmirsuan në përputhje me rekomandimet e KPMK

Clat rekomandime nuk janë zbatuar :

Në komunën e Pejës dhe Univerzitetin e Prishtinës akoma janë kontratat e punës për drejtorët e drejtorive komunale ,përkatësisht profesorët universitar në kohëzgjatje prej 4 vitesh edhe pse me nenin 3,3 të rreg.2001/36 është kjo të përcaktuar kohëzgjatja e tyre.

Në komunën e Pejës pas vizitës së fundit monitoruese janë marrë garanci se ky rekomandim i KPMK-së do të rrepektohet ,menjëher me rastin e vazhdimit të kontratatve të reja të punës në mars të vitit 2007 dhe se kontratat e reja të punës do jenë në përputhshëri me ligjin,ndërsa kontratatat e profesorëve Universitarë janë të shkruara sipas normave të Statutit të UP implementimi i rekomandimit të Këshillit varet nga dinamika e harmonizimit të Statuti të U.P

Në komunën e Kamenicës ,të Klinës e të Obiliqit K.E akoma nënshkruajnë kontratat e punës dhe në këtë drejtim KPMK në rast të mospërmbushjes së rekomandimeve do veprojnë në përputhje me ligjin.

Në këtë drejtim është e rëndësishme të përmendet se puna e mirë e menaxherëve të personelit në Autoritetet punëdhënëse ka bërë zbatimin të Ligjit për Shërbimin civil ti kushtohet rëndësi e posaçme dhe që procedurat e rekrutimit,dicitlinore dhe të ankimit brenda një autoriteti punëdhënës të SHCK të zhvillohen në të shumtën e rasteve në përputhje me dipozitat ligjore.

Këshilli vleron se menaxherët e personelit në KK-Viti, KK-Malishevë, KK-Shtime, MTPT. Qeverinë e Kosovës kanë dhënë kontribut të çmueshëm në organet e tyre punëdhënëse për aplikimin e ligjshmërisë në përgjithësi dhe të proceduarve të aplikueshme në shërbimin civil në veçanti.

Gjithashtu më të njëjtën kohë edhe Avokatët Publik të Komunave të Prishtinës, Skenderajit, Vushtrrisë dhe Ferizajit kanë treguar profesionalizëm të theksuar gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre dhe bashkpunim korrekt me këshillin

Pavarsisht nga fakti se ndikimi i tyre në rrjedhat e përgjithëshme në organin e tyre punëdhënës nuk ka qenë i plotë për shkak të natyrave të ndryshme.

AKTIVITETE TJERA TË KËSHILLIT

Këshilli i pavarur Mbikqyrës përpos detyrave të tija të zakonshme të parapara me Ligj dhe akte tjera juridike rëndësi të posaçme i ka kushtuar edhe bashkëpunimit me organe tjera dhe shtimit të njohurive profesionale të anëtarëve të vet duke shkëmbyer përvojat e punës me ato organe si dhe duke bërë përpjekje që eksperiencën e fituar ta aplikojë në veprimtarinë e tij të përditëshme.

Këtë kontekst KPMK ka zhvilluar vizitë pune në Republikën e Shqipërisë duke qenë mysafir i Komisionit të Shërbimit Civil të këtij vendi .
i raporton Kuvendit të Kosovës.

Vizita ka pasë për qëllim thellimin e bashkëpunimit shumë të mirë me këtë organ që ka veprimtari thujtë identike me KPMK dhe gjithashtu të trajtohet çështja e funksionimit të këtij komisioni ,relacionet me Kuvendin.linjat e përgjegjësisë dhe e tëra kjo në funksion të marrjës së informacioneve dhe dokumentacionit realavant i cili do ti shërbente procesit të Transformimit të KPMK-së në një organ të pavarur që Raporton drejtpërsdrejti Kuvendit të Kosovës.



Anëtarët e Këshillit në Tiranë



në Komisionin e Shërbimit Civil të Shqipërisë

Komisioni i Shërbimit Civil të Shqipërisë ka bërë një vizitë kthyesë në Kosovë Dhe me at rast kryetari i këtij komisioni i shoqëruar nga zyrtari për marrëdhënje me jashtë kan vizituar zyrat e KPMK-së ku janë njoftuar për të rezultatet e arritura të këshillit si dhe rrjedhat e përgjithshme në Shërbimin Civil të Kosovës.



Përfaqësuesit e Komisionit të Shërbimit Civil të Shqipërisë në KPMK-Prishtinë

BAHKËPUNIMI ME OSBE-në

Një kaptinë e veçant e aktiviteteve të KPMK-së gjat vititi 2006 ishte bashkpunimi shumë i frytshëm dhe reciprok me OSBE-në-misioni në Kosovë,

Ky bashkpunim fillimisht i inicuar nga vizita e zyrtarës së dep.të Demokratizimit z.Katja Salsback ,gradualisht shtohet në një aktivitet shumë të avancuar në disa segmente edhe të përbashkët.

Me rastin e vizitave monitoruese në Komunat e Kosovës me kërkesë të OSBE që natyrisht u parashtrua nga KPMK të pranishëm ishin edhe ekipet monitoruese komunale të OSBE.Në raste konkrete shkëmbimi i informacioneve për situata konkrete u tregua si shumë i dobishëm dhe rezultoi me eliminimin e parregullsisve të konstatuara në Shërbimin Civil të Komunës së caktuar.

Ky bashkpunim u thellua me ermirimin e një këshilltari të veçant për KPMK(jean Poll proloux) nga ana e OSBE i cili dha kontribut të çmueshëm në punën e KPMK-së

Si rezultat i këtij bashkpunimi OSBE- në në muajin shtator 2006 në OHËR të rep është mbajtur një seminar pune me prezencën e të gjithë anëtarëve të KPMK dhe përfaqësuesëve të OSBE-së.Seminari është mbajtur nga 12.09. deri më 15.09 2006 dhe ka shtjelluar tri tema kryesore::

1. **Transformimi i KPMK-së në një organ të pavarur që i raporton kuvendit të Kosovës në përputhje me nenin 7.2(pasuri i fundit) i të njejtës rregullore.**
2. **Seancat dëgjimore gjat zgjedhjes së ankesave**
3. **Prergaditjet për tryezën e rrumbullakët ndërrajonale me bordet e pavarura e ofruar dhe e finansuar nga OSBE e organizuar nga KPMK.**

Të gjitha shpenzimet materiale për organizimin e seminarit si dhe shpenzimet e akomodimit të plotë i ka bartur OSBE.Pas përfundimit të seminarit është sajuar bashkarisht një material prej rreth 40 faqesh që shpreh punën e bërë në seminar.(kopja e ballinës së broshurës }



Në bashkpunim me OSBE-Dep.e Demokokratizimit në muajin nëntor 2006 është mbajtur një seminar dy ditor në Hotel Prishtina në Prishtinë me Kryeshefat ekzekutiv dhe menazheret e personelit të Komunave të Kosovës me temë:”ROLI I Këshillit TË PAVARUR MBIKQYRËS Të KOSOVSËS NË MBIKQYRJEN E SHëRBIMIT CIVIL TË KOSOVSËS”

Në seminar kanë marrë pjesë edhe ekipet monitoruese komunale të OSBE-së dhe si nga pjesmarrësit ashti edhe nga OSBE është vlerësuar si shumë i suksesëshëm.

Para pjesmarrësve në seminar anëtarët e KPMK-së kanë shpjeguar funksionet e këshillit dhe kanë dhënë shpjegimet e nevojshme si dhe janë përgjegjur në pyetjet e shumta të pjesmarrësve në seminar.



panje nga seminari në Hotel Prishtina”roli i KPMK në Shërbimin Civil të Kosovës”



Në muajin dhjetor përkatësisht me 13 e 14 të këtij muaji në lokalet e Hotel “VIKTORY” në Prishtinë nën sponsorimin material të OSBE-së e cila ka paguar shpenzimet e akomodimit për pjesmarrës dhe të gjitha shpenzimet tjera materiale logjistike KPMK ka organiizuar një tryezë të rrumbullakët me karakter ndërkombëtar të parën të këtij lloji nga koha e egzistimit të tij.

Në tryezën me temë”ORGANET MBIKQYRËSE Të SHËRBIMIT CIVIL” kanë marrë pjesë organet mbikqyrëse të SHC nga Rumania,Slllovenia,Bosnja e Hercegovina,Maqedonia Shqipëria dhe në rolin e nikoqirit Kosova.

Tryezën në mënyrë solemne e hapën me nje fjalë rasti në emër të qeverisë së Kosovës z.Mark Komoni zv Ministër i MSHP dhe nga OSBE z,Jens Modwig zv,shef i misionit të OSBE për Kosovë,fjalë rasti paraqitën edhe kryetarët e dy komisioneve të Kuvendit të Kosovës znj, nekibe Kelmendi,kryteare komisionit Për Shërbime Publike.Administratë lokale dhe Media dhe z.Hydajet Hyseni kryetar i komisionit përKornizë kushtetuese

Ligjerues të temave të temave të parapara për konferencë ishin ekspert vendor e nderkombëtar,ndërsa edhe nga pjesmarrësit edhe nga OSBE ,Këshilli mori shum fjalë miradie për organizimin e konferencës.

Me këtë rast vlene të theksohet fjala e z.Rastko-Rafael Kozlevcar nga Slovenia i cili në mbyllje të konferencës theksoj” **kam qenë pjesmarrës is hum konferencave e seminareve ndërkombëtare por në jetën time kurr nuk jam ndie më më mirë se në Kosovë dhe për këtë nga zemra falenderoj nikoqirin e konferencës.”**



Pamje nga konferenca



Z. Jens Modvig zv. shef i OSBE-së dhe z. Mark Komoni zv. ministër i MSHP
Gjat punimeve të konferencës.

Me këtë rast falenderojmë përzemërsisht OSBE-në për bashkpunimin shumë korrekt dhe ndihmën e ofruar në aktivitetet e Këshillit duke shpresuar se ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe në të ardhmën.

RAPORTI ME MINISTRINË E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Në bazë të rreg.2001 /36 Ministria e Shërbimeve Publike ka një rol të veçantë në funksionimin normal e efektiv të KPMK-së. Obligimet e MSHP ndaj KPMK të parapara me ligj janë plotësisht të përmbushura.

Nga aspekti mbështës-technik KPMK-së i janë siguruar të gjitha pasijet e domosdoshme për funksionim ,ndërsa nga aspekti substancial KPMK ka vepruar tërësisht i pavarur.

Gjithashtu Ministrja e MSHP ka vizituar Këshillin duke i ofruar mbështetje të fortë dhe duke e cilësuar si një nga **”organet më të rëndësishme të Kosovës”** që për këshillin është edhe një shtytje me shumë për vazhdimin e aktivitetit të tij mbi baza profesionale.

RAPORTI ME KRYEMINISTRIN – QEVERINË E KOSOVËS

Nenet 8,11,4,12 al 1 (c) dhe 14.1 të rreg për Shërbimin Civil të Kosovës parashohin obligime direkte të KPMK-së ndaj Kryeministrit në kutim të informimit të tij nga ana e KPMK-së për rastet konkretidhur me aktivitetet e këshillit në të tri funksionet e tij.

Këshilli ka kryer obligimin e tij ligjor (në këtë raport janë dhënë disa shembuj) ndërsa kryetari i KPMK-së në emër të këshillit ka pasur takim pune me Kryeministrin dhe ka marrë mbështetje të plotë për punën e KPMK-së

Kryeministri Kosovës gjithashtu shumë shpejt ka dhënë pëlqimin për rrimimin e anëtarëve të këshillit që ka mundur vazhdimin e procesit të punës në KPMK dhe për këtë e falenderojmë sinqerisht.

RAPORTI ME PSSP

Bazuar në faktin se anëtarët e Këshillit emërohen nga PSSP në Konsultim me Kryeministrin ,si faktin e informimit obligativ të Këshillit për punën e KPMK-së,me zyrën e PSSP gjat tër vitit është zhvilluar një raport shumë korrekt dhe frytëdhënës.

Dy përfaqësues të këshillit kanë patur rastin të kenë takim pune me z.Petersen dhe me këtë rast nga PSSP ,këshilli mori përkrahje absolute për punën e tij.

Të njëjtën përkrahje këshilli e mori edhe nga PSSP i tashëm z.Rucker i cili pas përkrahjes në procesin e transformimit të ardhshëm të Këshillit bëri edhe riemërimin e tre anëtarëve të KPMK të cilëve u kishin skaduar kontratat e punës.

Një falenderim të posaqëm nga ana e KPMK e meritojnë z.Carlot Mercante dhe z.Artur Graham nga zyra e PSSP të cilët gjat tërë vitit në mënyrë konstatne kanë përkrahur këshillin .Gjithashtu edhe znj.Patricia Warning me përgjegjëjet e menjëhershme kundrejt kërkesave të shkruara të KPMK.

SFIDAT E TË ARDHMËS

Në vitin 2007 këshillin e presin aktivitete të ndrsyhmne disa prej të cilave cilësohen si SFIDA të vërteta të cilat kërkojnë **shum punë,,shum mund, dhe shum profesionalitet** për tejkalimin me sukses të tyre.

Më e rëndësishmja nga to është TRANSFORMIMI i këshillit në një organ të pavarur që derj përsëdrejti do ti raporton Kuvendit të Kosovës,

Ky proces me angazhimin e plotë të gjitha organeve të involvuara në te presim të përfundojë me sukses duke siguruar një pozicion të KPMK të njëjt me organet si këshilli në vendet e Europës dhe shtetet e perëndimit.

Zgjedhja e e ankesave të shërbyesëve Civil numri i të cilave në vitin 2007 pritet të jetë shumë më i madh shkak i shkurtimeve buxhetore. Për këtë qëllim është e nevojshme zgjedhja e shpejtë e anëtarit të shtatë të KPMK-së , përkushtimi edhe më i theksuar i anëtarëve të këshillit gjat ushtrimit të këtij funksioni dhe inkuadrimi edhe më i madh zyrtarëve të sekretariatit në këtë proces,

Raporti vjetor i Këshillit për vitin 2006 nuk ka pretenduar të jetë absolutisht gjithëpërfshirës,sepse edhe po ta kishte at synim do të ishte e pamundur të paraqiten të gjitha aktivitetet zhvilluara në këtë periudë,por shpresojmë se ia kemi arritur që pikat kyçe të punës së bërë gjat vitit të kaluar e kemi pasqyruar në mënyrë të duhur.

Të gjithë ata që ky raport i punës u dedikohet janë të mirseardhur të japin komentet,sygerimet e kritikrat eventuale për te.Secili koment që do të arrijë do të jeteë i vlefshëm për këshillin me qëllim të përmirësimit të punës në të ardhmën.

KPMK me këtë rast falenderon:UNMIK-un.Qeverinë e Kosovës,tOSBE-në të gjitha Ministrinë,Komunat e agjensionet Ekzekutive të Kosovës.Ombduspersionin e Kosovës,Mediat e shkruara e elektronike për raportim korrekt,DFID-in, dhe të gjitha organet e individët që dhan kontribut në punën e Këshillit.